



Pranuar / Doretuar Prenjeno/Protuto Received/Delivery	29.12.2020	viti god year	
Organ/Institucia Org. /Inst.	Pr. Prot. Pr. Prot. No.	Shtojca Pafilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHICK	3336/2020		116



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KESHILLI I PAVARUR MBIKEQYRES PER SHERBIMIN CIVIL TE KOSOVES
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUZBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.368/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Eshref Shabani-anëtar si dhe Avdyl Bektashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.368/2020 të datës 20.11.2020 të parashtruar nga ankuesi N.N me adresë rruga "Fehmi e Xhevë Lladrovci" në Komunën e Drenasit, kundër Vendimit me Nr. 01-116/01-44748 të datës 19.10.2020 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Drenasit, në çështjen juridike "masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 28.12.2020, mori këtë:

V E N D I M

I.APROVOHET si e bazuar ankesa me numër A.nr.368/2020 e datës 20.11.2020 e parashtruar nga ankuesi N.N.

II.SHFUQIZOHET Vendimi me Nr. 01-116/01-44748 i datës 19.10.2020 i Komisionit Disiplinor të Komunës së Drenasit.

III.OBLIGOHET Kryetari i Komunës së Drenasit, që ti ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme administrative, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, duke bërë kompensimin e pagës së ndaluar të ankuesit nga data e nxjerrjes së Vendimit me Nr. 01-116/01-44748 të datës 19.10.2020 të Komisionit Disiplinor i Komunës së Drenasit deri në zbatimin e këtij vendimi.

IV.Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi N.N, i punësuar në Komunën e Drenasit, kundër Vendimit me Nr. 01-116/01-44748 të datës 19.10.2020 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Drenasit me të cilin i është shqiptuar masa disiplinore **“Ndalim 40% i pagës për një periudhë prej gjashtë (6) muajve”**, të cilin e ka pranuar më datë 19.10.2020, më datë 18.11.2020 nëpërmjet postës ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është pranuar më datë 20.11.2020 dhe është protokolluar me Nr. Prot:2690.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 27.11.2020 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Komuna e Drenasit. Komuna e Drenasit më datë 04.12.2020 ka dërguar përgjigjen në ankesë me provat e bashkangjitura të lëndës, faqe 1-46.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit të datës 20.11.2020 me numër protokollit 2690/2020 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Raport “Studimi i Vlerësimit Strategjik Mjedisor për Hartën Zonale të Komunës së Glllogocit” 2020-2028; Vendimin me numër 12Nr.400/01-28767 i datës 30.07.2020 për Miratimin e Planit Zhvillimor të Glllogocit 2020-2028; Raporti i vlerësimit të ligjshmërisë së aktit të Komunës së Glllogocit datë 19.08.2020; Aktvendim i Drejtorit për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit së Komunës së Drenasit i datës 28.07.2011; Kontratë mbi dhënien e tokës komuna në shfrytëzim të përkohshme e datës 25.03.2009; Vendimin me Nr. 01-116/01-44748 të datës 19.10.2020 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Drenasit; E-mailin e datës 13.10.2020 nga Kimetet Sh. Qorri për ankuesin; E-mailin e datës 09.10.2020 nga ankuesi për Kimete Sh. Qorri; E-mailin e datës 13.11.2020 nga Bekim M Morina për ankuesin; E-mailin e datës 12.11.2020 nga ankuesi për Bekim M Morina; Lista e thirrjeve telefonike; Ftesë e datës 08.10.2020 për ankuesin; Propozim për iniciimin e masës disiplinore ndaj ankuesit e datës 06.10.2020; Raporti i një shkelje disiplinore të supozuar i datës 06.10.2020; Kërkesë për iniciimin e procedurës disiplinore 06.10.2020; Kërkesë për dhënien e pëlqimit për Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor për Hartën Zonale të Komunës së Glllogocit 2020-2028 i datës 27.08.2020; Njoftim publik për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për nëntëdhjetë e nëntë (99) vite të pronës së paluajtshme komunale; Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të komunës së Glllogocit nga MAPL i datës 11.09.2020; Zarin e datës 18.11.2020 të ankuesit; Akt emërimit e datës 14.06.2012 të ankuesit; Përshkrimin e detyrave të punës i datës 24.02.2014; procesverbali i mbledhjes së Komisionit Disiplinor i datës 12.10.2020; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin i datës 28.12.2018 dhe 30.12.2019; Transkripti; Vendim i datës 02.05.2019 për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës; Vendim i Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit i datës 14.09.2020; Njoftim i datës 09.01.2020; E-mailin e datës 08.10.2020 dhe 07.10.2020 nga Bekim M Morina për Hanumshahe S Hajdini; Fletë dorëzimit e datës 19.10.2020; Hartat Zonale të Komunës së Glllogocit draft 28.05.2020.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke u bazuar në këto rrethana, dhe pas shqyrtimit të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar që ankesa e ankuesit N.N, është e bazuar, **sepse:**

Ndaj ankuesit në bazë të Aktit të Emërimit të datës 14.06.2012 i punësuar në Komunën e Drenasit në pozitën “Shef i Sektorit” në Drejtorin e Urbanizmit, më datë 06.10.2020 Drejtori i Drejtoratit për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit ka përgatitur raportin e një shkelje të supozuar ndaj ankuesit me arsyetim se: **“...në**

procesin e dhënies së pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite, gjatë afatit të caktuar për dorëzimin e aplikacioneve dhe dokumenteve të kërkuar në Njoftimin Publik për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite të pronës së paluajtshme të komunës, Udhëheqësi i Sektorit për Planifikim Urban, N.N është takuar me një pjesëmarrës në konkurrim publik, duke mos qenë anëtar i komisioni për dhënien e pronës së paluajtshme në shfrytëzim dhe ka biseduar me ofertuesin, ndërsa ofertuesi në procesin e hapjes së ofertave më datë 02.10.2020 në ora 09:00 në sallën e bordit të drejtorëve, ka deklaruar se është tërhequr nga projekti dhe nuk ka ofertuar me atë projekt ideor të investimit pasi që është takuar dhe konsultuar me Zyrtarin e lartshënuar”. Mbi bazë të këtij raporti Drejtori i Drejtoratit për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit më datë 06.10.2020 ka parashtruar kërkesë për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit.

Komisioni Disiplinor i Komunës së Drenasit, më datë 19.10.2020 ka nxjerr Vendim me Nr. 01-116/01-44748 me të cilin ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore **“Ndalim 40% i pagës për një periudhë prej gjashtë (6) muajve”**.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon se: parashtruesja e kërkesës nuk ka bërë kualifikimin e shkeljes sipas nenit 46 të Ligjit për Zyrtarët Publikë; Kam kërkuar provat mbi bazë të të cilave ngarkohem dhe nuk më janë dhënë; Pala ofertuese është ftuar në seancë të komisionit disiplinor por nuk ka ardhur; Në këtë rast unë jam vënë në lajthitje sepse kjo pranohet edhe nga vete inicuesja e procedurës disiplinore dhe nga anëtarët për dhënien e pronave në shfrytëzim sepse asnjëherë nuk kam njoftuar palën ofertuese për me u tërheq nga aplikimi, por kam rënë në lajthitje të zyrtarëve dhe palës nga se unë vetëm i kam rekomanduar që të merr informata tek zyrtaret tjerë kompetentë.

Komuna e Drenasit më datë 02.05.2019 ka nxjerr Vendim me numër 12 Nr.400-23049 për formimin e Komisionit Vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës në përbërje prej pesë anëtarëve: Flutura Avdiu, Safet Hoxha, Florentina Kukaj, Sabrije Kukaj dhe Arben Kuliqi.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke shqyrtuar pretendimin ankimor të ankuesit i cili pretendon se parashtruesja e kërkesës nuk ka bërë kualifikimin e shkeljes sipas nenit 46 të Ligjit për Zyrtarët Publikë, ka konstatuar se Drejtori i Drejtoratit për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit në Komunën e Drenasit me rastin e përpilimit të raportit të një shkelje të supozuar ndaj ankuesit të datës 06.10.2020, nuk ka arritur të konstatoj se cilat nga shkeljet e rënda ka shkaktuar ankuesi, sepse Ligji Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, respektivisht neni 46 paragrafi 2 dhe 3 si dhe nën paragrafët nga 3.1 deri në 3.11, përcakton që duhet të saktësohet qartë se cilat nga shkeljet i ka shkaktuar nëpunësi civil, rrjedhimisht nëse marrim për bazë këto dispozita ligjore të ligjit mbi zyrtarët publik të potencuara më lartë kolegji ka konstatuar se pretendimi i ankuesit është i bazuar.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke shqyrtuar pretendimin ankimor të ankuesit i cili pretendon se kam kërkuar provat mbi bazë të të cilave akuzohem dhe nuk më janë dhënë, ka konstatuar që ankuesi më datë 09.10.2020 nëpërmjet e-mailit ka kërkuar provat e lëndës mbi bazë të të cilave është iniciuar procedura disiplinore respektivisht audio incizimet e takimit të komisionit me palën ofertuese po ashtu më datë 12.11.2020 ankuesi nëpërmjet e-mailit ka kërkuar edhe procesverbalin e komisionit disiplinor të datës 12.10.2020 mirëpo është njoftuar më datë 13.11.2020 **“se kundër vendimi të Komisionit Disiplinor ju keni të drejtën e ankesës në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe nëse KPMSHCK**

e kërkon procesverbalin ja dorëzohet e jo palëve tjera". Lidhur me këtë neni 15 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik, përcaktohet se: "Njësia për burime njerëzore shërben si sekretari për komisionin dhe ka këto përgjegjësi: Ofron faktet për Komisionin Disiplinor dhe palët në procedurë", po ashtu të drejtën që pala të njihet me dokumentet e dosjes së procedurës e ka përcaktuar neni 9 paragrafi 2 dhe neni 92 paragrafi 1 i Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton se: "paragrafi 2 i nenit 9, organi publik duhet të garantojë të drejtën e palës për t'u informuar mbi ecurinë e procedurës administrative, qasjen në dosjen dhe dokumentet e tij dhe të drejtën e njoftimit me mjete të përshtatshme, në pajtim me këtë Ligj", ndërsa "paragrafi 1 i nenit 92,pala, në çdo fazë të procedurës, ka të drejtë të njihet me dokumentet e dosjes së procedurës administrative dhe të marrë kopje të dokumenteve që gjenden në të", me këtë rast mos ofrimi i qasjes së ankuesit në dokumentet e procedurës është në kundërshtim me këto norma, kështu që pretendimi i ankuesit është i bazuar.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke shqyrtuar pretendimin ankimor të ankuesit i cili pretendon se pala ofertuese është ftuar në seancë të komisionit disiplinor por nuk ka ardhur, ka konstatuar se Komisioni Disiplinor për rastin e ankuesit ka mbajtur seancë dëgjimore ku sipas Procesverbalit të datës 12.10.2020 përcaktohet se "komisioni disiplinor përkundër ftesës që i është bërë Valdet Bujupit dhe Florentina Kukaj nuk kanë marrë pjesë në mbledhje...". Ofertuesi (Valdet Bujupi) i cili ka thënë që ankuesi i ka thënë "që nuk lejohet nuk jepet pëlqimi për pompë, për arsye se eee, merr hinë në internet i ki me shkrim, e ki pikën ku pompat e benzinit në vendbanim duhet të jenë se paku ni kilometër jashtë territorit të vendbanimit...", rrjedhimisht, i njëjti meqenëse është ftuar nga komisioni disiplinor nuk ka marr pjesë për argumentuar atë që ka thënë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në bazë të provave të lëndës respektivisht në Vendimin me Nr. 01-116/01-44748 të datës 19.10.2020 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Drenasit, në faqen 3 në fjalën e anëtarit të komisionit për shfrytëzimin e pronës së paluajtshme z. Safet Hoxha thekson se "në momentin që i kam dhënë numrin e telefonit Valdetit, ai më tha që e njoh Shabanin dhe unë i thash vazhdoni me Shabanin sepse unë kam një takim në sallë të bordit, pasi e kam kryer takimin e bordit prap jamë kthyer dhe në takim ishin dy personat e lartcekur (Valdeti dhe Jashari) dhe Shabani, në momentin e hyrjes në zyre une e kam dëshu Shabanin duke i thënë që konkretisht nuk e di se çka lejohet të ndërtohet, sepse planet i ka Besart Bajrami... Shabani ka dal i pari nga ky takim", inicuesja e procedurës disiplinore në po këtë faqe thekson se "...po shihet se nuk ka qenë me vetëdëshirë por rrethanat ia kanë krijuar hapësirën e takimin me ofertuesin, andaj juve ju mbetet të gjykoni", ndërsa anëtari tjetër i komisionit për shfrytëzimin e pronës së paluajtshme znj. Sabrije Kukaj në faqen 2 të vendimit të komisionit disiplinore thekson "se dërgimi i Shabanit në komision disiplinor është i ngutshëm dhe deklaroi se nuk është vetëm Shabani që ka qenë me palë, bile këtë e kanë dërgu palët dhe se asnjë anëtar nuk është dashur të takohet me palët...", rrjedhimisht në bazë të deklarimeve të palëve, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se inicuesja e procedurës disiplinore me rastin e paraqitjes së rastit të ankuesit në Komision Disiplinor është bazuar vetëm në deklarinimin e z. Valdet Bujupi, duke mos konsultuar personat e tjerë të rastit sepse takimin ankuesit me z. Bujupi ja ka mundur anëtari i komisionit për shfrytëzimin e pronës së paluajtshme z. Safet Hoxha, kështu që ankuesi nuk ka pasur përgjegjësi në rastin në fjalë dhe nuk ka bërë ndërhyrje në procesin e punës së këtij komisioni, sepse në transkriptin e dërguar nga Komuna e Drenasit me përgjigje në ankesë më datë 04.12.2020 askund nuk ka të shkruar deklarinimin e ankuesit ashtu siç pretendon z. Valdet Bujupi apo edhe inicuesja e procedurës disiplinore.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Komisioni Disiplinor i Komunës së Drenasit me rastin e nxjerrjes së Vendimit me Nr. 01-116/01-44748 i datës 19.10.2020, nuk ka arritur të konstatoj drejtë gjendjen faktike dhe bazën ligjore, sepse nuk ka bërë konstatim të drejtë të përmbajtjes së provave që kanë të bëjnë me rastin konkret, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 45, 46, 47 dhe 50 paragrafin 2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtaret Publikë, 11 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe 1.2, nenin 12 paragrafin 2 dhe 3 nën paragrafin 3.1, nenin 13 paragrafin 5 dhe nenin 15 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik sepse përveç që nuk ka konstatuar/vërtetuar shkeljen e supozuar nga ankuesi ka dështuar edhe sa i përket sanksionimit përmes kësaj mase disiplinore nga se në arsyetim të vendimit të komisionit mungon argumentimi sa i përket bazës ligjore për shqiptimin e kësaj mase. Po ashtu Vendimi me Nr. 01-116/01-44748 i datës 19.10.2020 i Komisionit Disiplinor i Komunës së Drenasit është në kundërshtim edhe me Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative respektivisht nenin 48 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2, 1.3 dhe 1.5 i cili përcakton se: ***“Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban: 1.2. shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi; 1.3. shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave; 1.5. shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve”***, meqenëse Vendimi me Nr. 01-116/01-44748 i datës 19.10.2020 i Komisionit Disiplinor i Komunës së Drenasit është i paqartë dhe kundërthënës është në kundërshtim me nenin 48 paragrafin 2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: ***“Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij”***, kështu që pretendimet e ankuesit janë të bazuara.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Kryetari i Komunës së Drenasit, është i obliguar që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi, duke bërë kompensimin e pagës së ndaluar të ankuesit nga data e nxjerrjes së Vendimit me Nr. 01-116/01-44748 të datës 19.10.2020 të Komisionit Disiplinor i Komunës së Drenasit deri në zbatimin e këtij vendimi.

Me dispozitat e nenit 21 paragrafit 1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është përcaktuar se: ***“Vendimi i Këshillit është vendim administrativ i formës së prerë dhe zbatohet nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës”***, ndërsa me dispozitat e nenit 24 paragrafit 1 të këtij ligji është përcaktuar se: ***“Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit sipas nenit 21 të këtij ligji, Kryetari i Këshillit nxjerr vendim për ndalimin e 50% të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit”***.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.368/2020; datë 28.12.2020

Avdyl BEKTESHI

Avdyl Bekteshi
Procesmbajtës



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit N.N;
- Kryetarit të Komunës së Drenasit;
- Menaxherit të Personelit në Komunën e Drenasit dhe
- Arkivit të KPMShCK-së.